

KONFERENCË

“Testimi ekstern i studentëve: sfidat dhe mundësitë”

SHKUP, 30 TETOR, 2014

PËRSHKRIMI

Organizata joqeveritare Qendra Evropiane SN7 ka nderin t'ju ftoj të merrni pjesë në konferencën me temë: “Testimi ekstern i studentëve: sfidat dhe mundësitë”, e cila do të mbahet më 30 Tetor 2014 (e enjte), në Shkup. Qëllimi i kësaj konferencës është shqyrtimi bashkërisht i sfidave, mundësive, barrierave dhe hapësirave/pengesave ligjore rreth iniciativës së paralajmëruar të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë për testim ekstern të studentëve të viteve të dyta dhe të katërta. Kjo konferencë është konceptuar si një mundësi e shkëlqyer për ndarjen e përvojave të përbashkëta dhe shkëmbimin e ideve për ngritjen e cilësisë së arsimit universitar, njëkohësisht duke ruajtur edhe autonominë e Universiteteve.

TË DREJTË PJESËMARRJEJE

Konferenca është e hapur për të gjithë të interesuarit, por kryesisht ju dedikohet atyre që janë të kyçur drejtpërdrejtë në procesin e arsimit universitar; stafit udhëheqës të Universiteteve, zyrtarëve qeveritar dhe të MASH-it, Këshillit të akreditimit dhe evolimit, Qendrës shtetërore për provime, profesorëve, juristëve, analistëve nga sfera e arsimit, organizatave studentore, organizatave civile që në fokusin e tyre kanë çështjet arsimore, parlamenteve studentore, studentëve etj.

KOHA & VENDI

Konferenca “Testimi ekstern i studentëve: sfidat dhe mundësitë”, do të mbahet më 30 Tetor 2014 (e enjte), me fillim nga 11:00 deri më ora 13:00, në hapësirat e Panairit të Shkupit (MBC Congress Center, Diplomatic Hall) në Shkup, Republika e Maqedonisë.

TEMA ME INTERES TË VEÇANTË

- Avantazhet dhe disavantazhet e testimit ekstern
- Kush duhet të realizoj testimin ekstern të studentëve: universitetet apo një institucion i jashtëm?
- A implikon ndryshime ligjore testimi esktern?
- A cenohet autonomia e Universiteteve me testimin ekstern të studentëve?
- Ndikimi i testimit ekstern për pajisje të studentëve me diploma meritore
- Rritja e cilësisë së arsimit të lartë: nevojë për autonomi të zgjeruar universitare apo implementim i mekanizmave të jashtëm?
- Përvojat ndërkombëtare rreth testimin ekstern studentor
- Testimi ekstern i studentëve si nevojë për unifikimin e planprogrameve universitare

PROCEDURAT E APLIKIMIT

PËR FOLËSIT / PANELISTËT: Abstraktet duhet të dërgohen në adresën: info@sn7.org.mk më së voni deri më datë 26.10.2014 dhe duhet të përmbajnë maksimum 100 fjalë. Nëse një abstrakt pranohet, punimi i plotë (maksimum deri më 1000 fjalë) duhet të dërgohet më së voni deri më datë 29.10.2014.

PËR PJESËMARRËSIT MYSAFIRË: Konferenca është e hapur edhe për publikun, të cilët duhet të konfirmojnë praninë e tyre në këtë adresë: info@sn7.org.mk më së voni deri më 29.10.2014, që të kenë mundësi të pajisen me certifikata pjesëmarrjeje. Pjesëmarrësit mysafirë do të kenë mundësinë të paraqesin qëndrime dhe opinione rreth temave të prezantuara apo të japin komentimin e tyre lidhur me tematikën e konferencës. Numri i pjesëmarrësve mysafirë është i limituar deri më 50 persona.